



Kujtim DOBRUNA

***Udhëzues mbi themelimin e ndërmarrjeve
të reja në Kosovë***

(Botimi i tretë)

© 2006 Nisma Ekonomike për Kosovën, Vjenë, Austri

Kontakt:

Economic Initiative for Kosova - ECIKS

E-Mail: info@eciks.org

Web: www.eciks.org

Përmbajtja

I. Parathënie	4
II. Hyrje	5
III. Ideja.....	6
IV. Plani i biznesit	7
V. Format juridike të ndërmarrjes	15
VI. Procedura e regjistrimit	19
VII. Financimi.....	21
VIII. Incoterms	22
VIII. Adresa të rëndësishme	24
IX. Aneks: Aplikacioni për regjistrim fillestar të biznesit	30

I. Parathënie

Shtyllë kryesore e ekonomisë moderne janë sot ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Në Bashkimin Evropian rreth 99% e të gjitha ndërmarrjeve janë NVM dhe punësojnë rreth 65 milionë njerëz. Këto ndërmarrje janë bërthama e inovacionit dhe bazë e zhvillimit të ekonomisë së një vendi. Ato i përshtatën shumë më lehtë ndryshimeve të jashtme dhe paraqesin bazën kryesore të targambledhjes. NVM-të janë ato që bartin barrën e zhvillimit të sektorëve të veçantë të ekonomisë dhe pak nga pak absorbojnë masat e gjera të të papunëve.

Për këto arsye, shtetet e Bashkimit Evropian ofrojnë programe të shumta të përkrahjes profesionale e financiare të këtyre ndërmarrjeve.

Duke dëshiruar të njëjtën për ndërmarrjet kosovare, ky publikim synon që themeluesve të ndërmarrjeve të reja vendore të ju ofrojë një përmbledhje të shkurtër të faktorëve më të rëndësishëm, që duhet marrë parasysh në periudhën e planifikimit të ndërmarrjes dhe lehtësimin e vendimmarrjes për një projekt të caktuar investiv.

Duke marrë parasysh dinamikën e lartë të ndryshimeve në botën afariste dhe domosdoshmërinë e përshtatjes së vazhdueshme të ndërmarrjeve në ecuritë moderne preferohet që në fazën vendimtare të planifikimit, idetë tuaja afariste të analizohen edhe me ndihmën e drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve dhe institucioneve të specializuara për këshillim.

Autori

*Rruga më e lehtë që fëmijët
tuaj të mësojnë për paratë,
është që ju të keni ndonjë para
(Katherine Whitehorn)*

II. Hyrje

)

Dëshironi të krijoni ndërmarrjen tuaj? Të jeni zot të vetvetes?

Besimi në idenë dhe në forcat vetanake, gatishmëria për të rrezikuar kapitalin, dëshira për pavarësi individuale, aftësia për të krijuar kontakte, motivacioni dhe zellshmëria dhe aftësia për të menduar dhe krijuar janë vetëm disa nga karakteristikat e një ndërmarrësi të suksesshëm.

Krahas kësaj, suksesi i ndërmarrësisë së mirëfilltë ndërlidhet drejtpërdrejt edhe me kualifikimet profesionale të themeluesit dhe me dituritë e tij në lëmin e biznesit. Nëse këto njohuri ju mungojnë, është i domosdoshëm vijimi i kurseve përgatitore nga lëmi i ekonomisë dhe biznesit dhe këshillimi me institucione dhe organizata të specializuara për këtë. Shërbime të këtilla ofron edhe Nisma Ekonomike për Kosovën – ECIKS dhe partnerët e saj.

Pikëmbështetje qenësore e ndërmarrësve të suksesshëm është mbështetja nga miqtë dhe familja në realizimin e idesë. Andaj kërkoni mbështetje dhe përkrahje nga rrethi juaj familjar, ngase kjo do ta ndihmojë realizimin e idesë suaj.

Krijimi i një ndërmarrje të suksesshme paraqet njëherësh edhe një bazë sigurie financiare për ju dhe familjen tuaj.

Këshilla juridike në hartimin e këtij udhëzuesi dha

AVOKATURA DOBRUNA

Ibrahim Z. DOBRUNA, Avokat

Tel. +377 44 156 663

Fax.: +381 38 585 222

E-Mail: avokatura@dobruna.com

Web: <http://www.dobruna.com>

Prishtinë, Kosovë

*Ti ke një ve, unë kam një ve, ne i këmbejmë ato...
Rezultati: Ti ke një ve dhe unë kam një ve!
Ti ke një ide, unë kam një ide, ne i këmbejmë ato...
Rezultati: Ti ke dy ide dhe unë kam dy ide!
(Proverb i vjetër kinez)*

III. Ideja

Sigurisht që para se të vendosni të futeni në biznes keni analizuar ide nga më të ndryshmet. Ka ndodhur ndoshta, që një ide të cilën e keni pasur ju në kokë, ta ketë realizuar me sukses dikush tjetër para jush. Kjo natyrisht që sjell kokëçarje. Por, kjo nuk bën të ju tremb, ngase vetëm 2 për qind e ideve arrijnë të realizohen dhe të sjellin sukses. Ndërsa, vetëm 60 për qind e produkteve të dala në treg janë të suksesshme. Pjesa tjetër dështojnë.

Nuk ekziston ndonjë sistem për vlerësimin e ideve në fazën fillestare e as nuk ka ndonjë formulë, që garanton suksesin e një ideje. Analizimi i faktorëve kyç të ekonomisë së një vendi, si: tregu, teknologjia, resurset dhe kapitali janë parakushte për suksesin e një ideje. Krahas kësaj duhet gjetur përgjigjen në pyetjet vijuese:

- Për çfarë qëllimi nevojitet produkti/ideja e planifikuar?
- A ka kërkesë të mjaftueshme në treg?
- A mund të kem sukses?
- A e vlen të realizohet kjo ide?

Në çdo fazë të zhvillimit të ideve dhe projekteve të reja gjithnjë duhet të keni parasysh formulën vijuese: *“Planifiko, analizo, vlerëso dhe në fund realizo!”*

Sapo të keni vendosur për realizimin e idesë, duhet të përgatisni planin e biznesit për ndërmarrjen tuaj.

*Nëse me të vërtetë mund të numërosh paratë tua,
atëherë nuk mund të konsiderohesh si njeri i pasur
(Paul Getty II)*

IV. Plani i biznesit

1. Masat përgatitore

Themeluesit e ndërmarrjeve të reja, qysh para fillimit të realizimit të projektit investiv, duhet të ndërmarrin disa masa përgatitore me rëndësi, si p.sh.:

- Të sigurohen informatat lidhur me degën, tregun e shitjes dhe furnizimit, prodhimet konkurruese (p.sh. çmimet, sasi të), koston (p.sh. çmimet e blerjes, çmimi i rrymës, pagat), si dhe lidhur me rregullativën ligjore (p.sh. kontributet ligjore sociale, doganat për import, lejet e nevojshme) etj.
- Të bëhen biseda me bankën apo dhënësit tjerë të kredive për të siguruar financimin e plotë të projektit tuaj.
- Të bisedohet me qiramarrësin e lokalit afarist, eventualisht me afaristin e mëparshëm dhe të bëhet lidhja e parakontratës, nëse për një gjë të tillë ekziston mundësia.
- Bisedimet konsultuese për projektin Tuaj me Odën Ekonomike apo me ndonjë zyrë ose Institut tjetër me kompetencë profesionale, furnitorët dhe kontaktet me konsumatorë Kontaktet me zyrat shtetërore (a ka programe publike të mbështetjes financiare, lehtësime tatimore etj. mundësisht të merren qëndrimet në formë të shkruar lidhur me to).
- Nëse njohuritë nga lëmi i ekonomisë (kontabiliteti, marketingu etj.) nuk janë të mjaftueshme, atëherë preferohet vijimi i ndonjë seminari apo kursi ekonomik pranë Odës Ekonomike, apo institucioneve të ngjashme.

2. Koncepti i ndërmarrjes

Koncepti i ndërmarrjes tuaj duhet të përmbajë këto pika:

- përshkrimin e projektit
- analiza e tregut
- planin investues dhe financiar
- vlerësimin ekonomik

2.1 Përshkrimi i projektit

Paraqitni me fjalë të shkurtra idenë e projektit tuaj dhe jepni sa më shumë të dhëna lidhur me këto pika:

Qëllimi i ndërmarrjes

Në cilën degë dëshironi të ushtroni veprimtarinë tuaj? Çfarë do të prodhoni, shitni apo çfarë shërbimesh do të ofroni?

Forma juridike

A do të jeni vetëm ju pronar i ndërmarrjes apo ndërmarrja do të udhëhiqet nga shumë persona? Sa bashkëpronar do të ketë ndërmarrja? Cili është funksioni tyre? Kush është drejtues i ndërmarrjes?

Vendndodhja/Selia

- Në cilin vend dëshironi të kryeni veprimtarinë Tuaj?
- A është selia e ndërmarrjes Tuaj në qendër, në periferi të një qyteti të madh apo në brendi të vendit?

Trualli dhe ndërtesa

- A dëshironi ta kryeni veprimtarinë tuaj në lokalet dhe truallin Tuaj (kontratën e blerjes së truallit apo dokumentin mbi pronësinë duhet te keni në dispozicion) apo lokalet për ndërmarrjen Tuaj do ti merrni me qira?
- Sa është lartësia mujore e qirasë? A duhet paguar kaucion për lokalet e marra me qira? Sa do të zgjasë kontrata e marrjes me qira? (kontratën e marrjes me qira duhet ta keni në dispozicion)
- Çfarë duhet ndërtuar, rindërtuar apo rinovuar? Sa do të zgjasin punët ndërtimore?
- A ka rrugë, rrymë, ujë dhe kanalizim në vendin ku do ta vendosni ndërmarrjen, a mund të sigurohen lehtë apo vështirë të gjitha ato dhe çfarë është mundësia e kyçjes së telefonit?

Numri i bashkëpunëtorëve

- Sa bashkëpunëtorë do ti punësoni? Sa prej tyre do të jenë të angazhuar me gjysmë orari se sa me kohë të plotë? Në cilat funksione do ta kryejnë veprimtarinë e tyre bashkëpunëtorët tuaj?

2.2 Analiza e tregut

Përgatitni analizën e tregut duke bërë analizën e ofertës dhe kërkesës. Përveç kësaj, ju duhet të shënoni se si e keni paraparë të krijoni vend në treg për ndërmarrjen tuaj.

Tregu i ofertës

Analiza e tregut të ofertës do të duhej të Ju ofrojë të dhëna lidhur me gjendjen e konkurrencës si dhe mundësitë e plasmanit (vlerësimi i kërkesës) të shërbimeve tuaja.

Në **analizën e konkurrencës** ju duhet të shënoni se sa konkurrentë gjenden në afërsi të selisë suaj, çka dhe sa ofrojnë ata, si dhe cilat janë anët e tyre të forta dhe të dobëta.

Verifikoni se a vijnë ofertat e tyre nga prodhimi nacional apo nga importi. Përpiquni të kuptoni se a dëshirojnë edhe konkurrentët tjerë të paraqiten në atë treg apo se konkurrentët ekzistues planifikojnë të ofrojnë edhe më shumë në atë treg. Sa i vlerësoni se janë të mëdha mundësitë tuaja që të futeni në atë treg?

Gjatë **vlerësimit të nevojës** ju duhet të përshkruani se kush do të ketë nevojë për prodhimet/shërbimet Tuaja. Të tilla mund të jenë p.sh. amvisëritë private, ndërmarrjet industriale apo institucionet publike (shkollat, spitalet etj.). Sa konsumatorë potencial ekzistojnë? Sa janë të mëdha nevojat e tyre? Vlerësoni se sa e madhe është kërkesa e përgjithshme për këto prodhime/shërbime në hapësirën e tregut Tuaj. Bëni një vlerësim se si do ta zhvilloni kërkesën për prodhimet e planifikuara nga ju në tregun tuaj.

Paraqitni kontaktet që keni me konsumatorët si dhe dëshmitë për porositë e tyre nëse ato ekzistojnë.

Tregu i furnizimit

Nga do të sigurohen në mënyrë të shpejtë dhe të volitshme të gjitha gjërat e nevojshme për prodhimet e parapara nga Ju, siç është lënda e parë, materiali, mallrat, energjia apo fuqia punëtore e kualifikuar. Është me rëndësi po ashtu të sqaroni, se a mund të siguroni pjesë rezervë për makinat dhe automjetet Tuaja.

2.3 Plani financiar

Investimet e përgjithshme do të duhet të mbulohen me anë të planit financiar. Si burim financiar konsiderohen mjetet vetanake dhe kreditë. Mjete vetanake konsiderohen mjetet në para të gatshme dhe gjërat me vlerë. Gjërat me vlerë janë p.sh. automjetet, makinat, veglat zejtare, kompjuteri personal, por të tilla janë edhe trojet dhe ndërtesat.

Kreditë apo kapitali i huaj mund të jenë në formë të kredive bankare apo të kredive private. Është e preferueshme, që në projekt të njoftohet për rrjedhën e bisedimeve

me kredidhënësit dhe të bashkëngjitni kopjen e kontratës për kredi nëse e posedoni një të tillë. Kontrata e kredisë duhet të përmbajë shënimet për qëllimin e përdorimit, lartësinë e kredisë, kamatat, kohëzgjatjen dhe periodën kur jeni të liruar nga kthimi i kësteve. Kontrata duhet të jetë e nënshkruar nga kredidhënësi dhe kredimarrësi.

Vlerësimi ekonomik

Me anë të vlerësimit të ekonomik duhet dhënë përgjigje në këto pyetje:

- Me cilën shumë të qarkullimit mund të llogaritni?
- Cilat do të jenë shpenzimet?
- A mund të synohen fitime me projektin Tuaj? Prej kur dhe në çfarë lartësie?
- A janë harmonizuar të hyrat dhe të dalurat e parapara në lartësi dhe kohë ashtu që ndërmarrja e re të jetë gjithmonë solvente?

Përgjigjet në këto pyetje mund t'i merrni nëse mundësisht në mënyrë sa më reale vlerësoni shumën e qarkullimit dhe shumën e shpenzimeve. Nga këto vlerësime pastaj mund të paraqitni pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve dhe pasqyrën e likuiditetit.

Vlerësimi i shumës së qarkullimit

Shumën e qarkullimit e llogaritni nga “sasia*çmimi” i prodhimeve/ shërbimeve të shitura (p.sh. 200 copë * 2,50 € = 500,-- € qarkullim). Në vlerësimin e shumës së qarkullimit duhet paraparë:

- sa copë të një prodhimi në një periodë të caktuar (një muaj apo një vit) mendoni se është reale se do të shitni. Në vend të një prodhimi mund të jetë një shërbim, p.sh. riparimi i motorit apo një veprimtari këshilluese,
- me cilat çmime mendoni se këto prodhime/ shërbime do të mund t'ua shitni konsumatorëve Tuaj?

Vlerësimi i sasisë së shitjes

Vlerësimi real i sasisë së shitjes është shumë me rëndësi. Ky vlerësim, para së gjithash, mund të jetë vendimtar në fazën e parë për të përcaktuar se a do t'ia dilni që në start apo do të dështoni.

Llogaritni se sa prodhime apo shërbime tuajat gjatë një vlerësimi të kujdesshëm do të mund ti shisni në vendin ku është vendosur ndërmarrja juaj. Sa prodhime do të shisni gjatë javës së parë? Sa në muajin e parë?

Si do të zhvillohet shitja më tutje gjatë 12 muajve të parë? Mundësisht duhet të merren në konsiderim rëniet sezonale). Mblidhni pastaj shitjet vjetore që planifikoni ti bëni dhe vlerësoni duke marrë në konsiderim ngritjet e çmimeve të shumave të qarkullimit për vitin e 2. dhe 3. afarist.

Përcaktimi i çmimeve

Përcaktimi i çmimeve të prodhimeve nganjëherë shkakton probleme. Kjo vlen para së gjithash për shërbime, p.sh. zyra e arkitektëve, avokatët, mjekët, etj. Por edhe një mjek mund të vlerësojë p.sh. se:

- sa kontrollime normale, sa me Rëntgen apo me ultrazë të pacientëve mund ti ketë?
- sa kohë i nevojitet mesatarisht për kontrollime të ndryshme?
- sa mund të kërkojë nga pacientët për kontrollime të veçanta në formë të honorarit?

Vlerësimi i shpenzimeve

Shpenzimet paraqesin shpenzimet rrjedhëse të shprehura në të holla (p.sh. në euro) për material, energji, fuqi punëtore, për amortizimin e makinave, për kamatat në kreditë e marra etj. Në shpenzime nuk bien p.sh. kapitali investues, të dalurat për deponimin rezervave (pjesë me rëndësi e kapitalit qarkullues) apo kthimi i kredive. Shpenzimet e ndërmarrjes ndahen në shpenzime fikse dhe shpenzime variabile. Shpenzimet fikse janë të pavarura nga prodhimi dhe kanë gjithmonë lartësi të njëjtë

(p.sh. qiraja), ndërsa shpenzimet variable ndryshojnë me lartësinë e prodhimit dhe janë të varura nga prodhimi (p.sh. shpenzimet për material).

Mendoni se cilat shpenzime do t'i keni pas fillimit të veprimtarisë afariste dhe si do të rritën ato me rritjen e prodhimit tuaj, gjegjësisht të shërbimeve tuaja.

Paraqitni në mënyrë tabelore zhvillimin e shpenzimeve të parapara për vitin e parë dhe për vitet e mëvonshme afariste (keni parasysh ngritjen e çmimeve).

2.4 Humbjet në fazën fillestare

Në fazën fillestare ndërmarrja shpesh nuk mund të mbulojë shpenzimet në mënyrë të plotë nga shuma e qarkullimit. Me këtë rast krijohen humbjet fillestare të punës të cilat duhet të mbulohen nga mjetet financiare plotësuese.

Humbjet fillestare mund të vërehen duke i zbritur shpenzimet mujore dhe të ardhurat e ndërmarrjes nga shuma mujore e qarkullimit. Vlera negative në këtë rast do të thotë humbje. Vlera e gjithëmbarshme paraqet shumën e humbjeve fillestare dhe duhet të merret në konsiderim në planin investiv.

Nëse ju nuk keni humbje fillestare, atëherë nuk keni nevojë që këto t'i merrni në konsiderim në planin investues.

Pasqyra e fitimit dhe humbjeve

Duke përgatitur një tabelë ju mund të vëreni fitimin apo humbjen që fillimisht shkakton projekti juaj. Në tabelën tuaj, në rubrikën e parë paraqitni shumën e qarkullimit të realizuar, në rubrikën e dytë vlerësimin për shpenzimet dhe në rubrikën e tretë paraqitet një pozicion special:

Amortizimi

Amortizimi paraqet konsumimin e makinave, automjeteve, ndërtesave etj. (trualli nuk

shpenzohet). P.sh.: Një makinë me vlerë prej 24.000,-- € ka afatin e qëndrueshmërisë 10 vite, që do të thotë për çdo vit ajo humb nga vlera e saj 2.400,-- € (që është 10% e vlerës blerëse). Këto 2.400,-- € në vit (apo 200,-- € në muaj) janë shpenzimet të cilat duhet zbritur nga fitimi. Meqë fitimi tani është më i ulët institucioneve tagrambledhëse duhet paguar më pak tatim. Shpenzimet e amortizimit janë *shpenzime të kalkuluara*, që do të thotë ato nuk paguhen por mbesin në arkë në mënyrë që në një moment tjetër kohor të përdoren.

Shuma e qarkullimit, minus shpenzimet, minus amortizimi, do të japin fitimin apo humbjen që llogaritet para tatimit në fitim. Gjatë humbjeve nuk jeni të obliguar të paguani tatim në fitim.

Fitimi minus tatimi në fitim, jep fitimin pas tatimit.

2.5 Pasqyra e likuiditetit (planifikimi i Cash Flow)

Tani ju duhet të vlerësoni, se a mund të jetoni nga ky fitim i tatuar dhe a mund të arrini ta tejkaloni vonesën në pagesë nga ana e konsumatorëve Tuaj në mënyrë që obligimet e pagesave ti kryeni me kohë. Këtë mund ta konstatoni me anë të pasqyrës së likuiditetit apo me planin e rrjedhjes së parave të gatshme.

2.6 Fjala përfundimtare

Përpiquni që me ndihmën e këtyre udhëzimeve të hartoni përshkrimin e projektit duke aplikuar edhe format tabelore, në mënyrë që të jepni shënime të detajuara lidhur me pikat e cekura më lartë.

*Mund të jesh i ri dhe pa para,
por i vjetër kurrësi jo!
(Tennessee Williams)*

V. Format juridike të ndërmarrjes

Ligjet ekzistuese në Kosovë njohin format vijuese juridike të ndërmarrjeve:

- a) Bizneset Individuale;
- b) Shoqëritë Kolektive;
- c) Shoqëritë Komandite;
- d) Korporatat (Shoqëritë Aksionare dhe Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar).

Të drejtat dhe detyrimet, përgjegjësite dhe mënyrat e organizimit të ndërmarrjeve duhet të jenë në përputhshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/6 të datës 8 shkurt 2001.

a) Bizneset Individuale

Bizneset Individuale nuk mund të vlerësohen si persona juridik pavarësisht prej regjistrimit, posedimit të ndonjë licence apo emrave tregtar. Secili biznes individual llogaritet si person fizik.

Përgjegjësia

Personi fizik që kryen veprimtari si një ndërmarrje individuale afariste mban përgjegjësi për të gjitha borxhet e krijuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij me gjithë pasurinë e tij. Pasuria që nuk përdoret për zhvillimin e biznesit individual nuk guxon të ndahet nga pasuria e që përdoret për këtë qëllim, përpos në rastet kur ligji parasheh përjashtime.

b) Shoqëria kolektive

Shoqëria kolektive është rezultat i bashkimit të dy a më shumë personave me qëllim të zhvillimit të veprimtarive tregtare. Personat që bashkohen në këtë mënyrë quhen

“ortakë të pakufizuar”. Për themelimin e kësaj shoqërie nuk është e domosdoshme marrëveshja me shkrim.

Përgjegjësia

Ortakët mbajnë përgjegjësi kolektive dhe individuale për borxhet dhe detyrimet e tjera të shoqërisë kolektive me tërë pasurinë e tyre. Shoqëria nuk është person juridik, por ajo mund të lidhë kontrata, të ketë pasurinë e saj dhe të padisë apo të paditet në emër të saj, si dhe në emër të ortakëve të saj. Çdo gjykim kundër shoqërisë është i zbatueshëm si ndaj pasurisë së përbashkët të shoqërisë ashtu edhe ndaj pasurisë private të të gjithë ortakëve.

Ortakët në shoqërinë kolektive duhet të japin kontributin e tyre për përballimin e barabartë të humbjeve eventuale që rrjedhin nga veprimtaria tregtare e shoqërisë. Fitimi ndahet në mënyrë të barabartë.

c) Shoqëria komandite

Shoqëria komandite është shoqëri tregtare e përbërë nga të paktën një ortak i pakufizuar dhe një ortak i kufizuar. Ajo themelohet me regjistrimin e aktit të themelimit të shoqërisë komandite në agjencinë e cila është e autorizuar të regjistrojë shoqëritë tregtare. Akti i themelimit i shoqërisë komandite duhet të përfshijë emrin e plotë dhe adresën e vendbanimit të secilit ortak të pakufizuar që është person fizik si dhe emrin dhe selinë e secilit ortak që është person juridik.

Përgjegjësia

Ortakët e pakufizuar kanë përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e shoqërisë komandite, ndërsa ortakët e kufizuar mbajnë përgjegjësi deri në kufirin e kontributit të tyre në shoqërinë komandite.

Kapitali

Kapitali themelor i shoqërisë komandite përbëhet nga kontributet e ortakëve të pakufizuar dhe të kufizuar. Shuma e kapitalit themelor që duhet investuar nuk është e përcaktuar.

d) Korporatat

Korporata është shoqëri tregtare, kapitali i së cilës ndahet në një numër të caktuar aksionesh me të njëjtën vlerë nominale. Korporata është person juridik dhe mund ta zotërojë pasurinë në emrin e vet.

Një ose më shumë persona fizikë ose juridikë mund të themelojnë një korporatë dhe të zotërojnë aksionet e saj.

Përgjegjësia

Aksionarët e korporatës nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë. Pasuria e korporatës është e veçantë nga pasuria e themeluesve dhe aksionarëve të korporatës. Korporata përgjigjet për detyrimet e veta me të gjithë pasurinë e saj. Korporata nuk përgjigjet për detyrimet e themeluesve apo aksionarëve të saj. Aksionarët fillestarë të cilët nënshkruajnë aksionet për korporatën janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për detyrimet e korporatës, në qoftë se nuk kanë derdhur kontributin e tyre në kapitalin themelor të korporatës.

Korporata mund të jetë **Shoqëri Aksionare** ose **Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar**.

Shoqëri Aksionare (Sh.A.) quhet korporata, pronarët e së cilës mund t'i transferojnë aksionet e tyre pa miratimin e aksionarëve të tjerë ose të shoqërisë. Shoqëria Aksionare mund të bëjë një ofertë publike për aksionet e saj sipas kushteve të parashikuara me ligj.

Kapitali

Shuma minimale që duhet investuar për regjistrimin e një Shoqërie Aksionare është 25.000 euro.

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) quhet korporata, aksionet e së cilës shpërndahen vetëm ndërmjet themeluesve të saj ose ndërmjet personave të tjerë të përcaktuar paraprakisht. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nuk mund të bëjë ofertë

publike për aksionet e saj e as t'ia ofrojë këto aksione në ndonjë mënyrë tjetër një numri të pakufizuar personash. Numri i aksionarëve në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar nuk duhet të jetë më i madh se pesëdhjetë. Nëse ky numër tejkalohe, atëherë kjo shoqëri duhet të riorganizohet dhe të marrë formën e Shoqërisë Aksionare.

Kapitali

Shuma minimale që duhet investuar për regjistrimin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar është 2.500 euro.

VI. Procedura e regjistrimit

Regjistrimi i përkohshëm i ndërmarrjeve në Kosovë është bërë gjer më tani në pajtim me Rregulloren nr. 2000/1 të datës 14 janar 2000. Ndërsa, nga maji i vitit 2003 regjistrimi i bizneseve ka kaluar në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, respektivisht të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ky regjistrim bëhet konform udhëzimit administrativ Nr. 2003/1

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve (<http://www.arbk.org>) është hapur në fund të vitit 2002 dhe ka selinë në ndërtesën e Fakultetit të Ri Ekonomik, zyra nr. 8. Kjo është një agjenci e pavarur ekzekutive dhe hyn në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Në të bëhet regjistrimi i bizneseve të reja dhe bizneseve të regjistruara më parë si të përkohshme pranë UNMIK-ut.

Për regjistrimin e ndërmarrjeve Zyra e Regjistrimit ka përgatitur formularët e nevojshëm, të cilët ndahen në katër grupe: A, B, C, D.

Formulari A shërben për regjistrimin fillestar si dhe për ndryshime në shoqërinë aksionare, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuara, ortakërinë e kufizuar ose kompaninë e huaj;

Formulari B shërben për regjistrimin e ndërmarrjes së re apo për ndryshime në biznesin individual apo në ortakërinë e përgjithshme.

Formulari C shërben për regjistrimin e emrit tregtar dhe

Formulari D shërben si dëshmi për përmbushjen e të gjitha obligimeve tatimore me një dokument përcjellës nga Autoriteti Tatimor.

Sa për ilustrim Formulari A është futur në aneksin I të këtij udhëzuesi. Sidoqoftë, formularët komplet për regjistrim mund të merren pranë Zyrave kompetente të Regjistrimit.

Për regjistrimet e bizneseve nëpër komuna përgjegjëse janë Zyrat rajonale të MTI-së.

Aplikuesve të cilët i plotësojnë kushtet e parapara ligjore, Zyra e Regjistrimit u lëshon certifikatën e regjistrimit, e cila i dërgohet atyre përmes zyrave regjionale të MTI-së.

Themeluesi i ndërmarrjes është përgjegjës për dorëzimin e të gjitha informatave dhe për mbështetjen e dokumentacionit ndihmës për regjistrim të biznesit, siç kërkohet përmes formularëve të konkurrimit.

Taksat e fletëparaqitjes për regjistrim dhe për arkivimin e statutit apo memorandumit të ri janë 20 €. Për ndryshimet eventuale të mëvonshme në statut, në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes, apo për raportet vjetore dhe pasqyrat financiare duhet të paguhen taksa prej 2 deri në 10 €, varësisht nga forma juridike e biznesit. Këto taksa duhet të paguhen më parë në banka në llogari të Zyrës së Regjistrimit dhe dëshmitë e pagesave duhet bashkangjitur dokumenteve që dorëzohen në Zyrat Regjionale për Regjistrim.

Për ndërmarrjet që janë të regjistruara në botën e jashtme, vlejné të njëjtat detyrime dhe të drejta, si për ndërmarrjet vendore. Mirëpo, këto ndërmarrje për të kryer veprimtari tregtare dhe shërbime në Kosovë, duhet të regjistrojnë një njësi apo zyre përfaqësimi në Kosovë dhe të kenë agjentin e regjistruar në adresën e njësive të tyre në Kosovë.

*Bëje atë që mundesh,
kurse kudo që mundesh,
jep çka do që mundesh.
(John Wesley)*

VII. Financimi

Shikuar nga aspekti i ndërmarrjes, financimi nuk është asgjë tjetër përpos sigurim i mjeteve të mjaftueshme monetare për realizimin e suksesshëm të qëllimeve afariste. Jo vetëm për fillimin e veprimtarisë afariste, por edhe për mbarëvajtjen e saj nevojiten burime të mjaftueshme financiare.

Njihen dy forma bazë të financimit të ndërmarrjes: **financimi i jashtëm**, që bëhet me duke sjellë kapitalin nga jashtë dhe **financimi i brendshëm**, që mundësohet përmes realizimit të veprimtarive afariste (të hyrat nga qarkullimi ditor, nga shitja e shërbimeve apo produkteve). Përderisa financimi i brendshëm është përditshmëri në çdo ndërmarrje të etabluar, financimi i jashtëm nevojitet fillimisht për të siguruar nisjen e realizimit të projekteve investive e më pastaj edhe për financim të pjesëm të veprimtarive të përditshme afariste.

Për të siguruar një kredi nga bankat, sot nuk mjafton të paraqitësh vetëm bilancin e ndërmarrjes. Bankat gjithnjë e më shumë aplikojnë metodat e klasifikimit (Rating), të cilat përshkruajnë saktë metodat e vlerësimit të bonitetit të ndërmarrjeve. Sa më i mirë boniteti, aq më të larta janë gjasat për kthimin e kredisë dhe anasjelltas. Një bonitet i lartë mundëson kredi me kushte më të përshtatshme duke përfshirë edhe normat më të ulëta të interesit.

Për projekte të reja dhe themelime të reja të ndërmarrjeve (start-up) kapitali financiar mund të sigurohet nganjëherë edhe në formë donacionesh nga institucionet zhvillimore jokomerciale. Në shtojcë të kësaj broshure gjendet një listë me të dhëna për këto institucione.

Për projektet me kohëzgjatje të madhe të realizimit, preferohen kreditë afatgjata dhe anasjelltas. Përpos financimeve themelore të projektideve bankat ofrojnë edhe kreditimin “Kontokorrent”, që është një formë e kreditimit të rregullt, përmes të cilit ndërmarrësit i mundësohet shfrytëzimi i mjeteve të caktuara mujore për përmbushjen e obligimeve rrjedhëse. Kjo mundësi është mjaft e mirë për të garantuar likuiditetin afatshkurtër të ndërmarrjes, por karakterizohet me kamata shumë të larta efektive.

VIII. Incoterms

Për të pamundësuar keqkuptimet dhe keqinterpretimet e kontratave në tregtinë e jashtme janë nxjerrë rregullat unike ndërkombëtare të njohura si INCOTERMS. Janë gjithsej 13 klauzola të përcaktuara, që do të paraqiten në vijim:

1. **EXW: Ex Works**

Nga fabrika, nga depoja, etj. Malli ofrohet nga shitësi në truallin e tij. Blerësi bartë përsipër të gjitha shpenzimet e transportit dhe rrezikun e transportit.

2. **FCA: Free Carrier**

Shitësi duhet të përkujdeset për ngarkimin e rregullt të mallit. Blerësi bart shpenzimet e dhe rrezikun e transportit nga momenti i bartjes së mallit nga shitësi tek transportuesi.

3. **FAS: Free Alongside Ship**

Shitësi paguan transportin e mallit deri te liferimi përbri anijes. Deri në këtë moment ai bartë përsipër rrezikun e transportit.

4. **FOB: Free on Board**

Shitësi paguan shpenzimet e transportit deri në portin e dërgesës. Ai bartë përsipër rrezikun deri në momentin kur malli i kalon shinat e anijes në portin e dërgesës

5. **CFR: Cost and Freight**

Shitësi paguan shpenzimet e transportit deri në portin e destinimit. Ai bart rrezikun deri sa malli të ketë kaluar shinat e anijes në port.

6. **CIF: Cost, Insurance and Freight**

Shitësi i paguan shpenzimet e transportit, duke përfshirë edhe sigurimin detar, deri në portin e destinimit. Ai mban përsipër rrezikun deri sa malli të ketë kaluar shinat e anijes në portin e dërgesës.

7. **DES: Delivered EX Ship**

Shitësi paguan shpenzimet e transportit dhe bart përsipër rrezikun deri sa malli të ketë arritur në portin e destinuar.

8. DEQ: Delivered Ex Quay

Shitësi i paguan shpenzimet e transportit dhe të doganës dhe bartë përsipër rrezikun deri sa malli është në breg të portit të destinuar.

9. DAF: Delivered At Frontier

Shitësi i paguan të gjitha shpenzimet dhe bart rrezikun deri sa malli të liferohet në anën e tij të kufirit.

10. DDP: Delivered Duty Paid

Shitësi i paguan të gjitha shpenzimet, duke përfshirë doganën, dhe bart rrezikun deri sa malli t'i liferohet blerësit.

11. DDU: Delivered Duty Unpaid

Shitësi i paguan të gjitha shpenzimet, pa përfshirë doganën, dhe bart rrezikun deri sa malli t'i liferohet blerësit

12. CPT: Carriage Paid To

Shitësi i paguan shpenzimet e transportit deri në vendin e destinuar. Ai bart përsipër rrezikun deri sa mallit të pranohet nga transportuesi i parë.

13. CIP: Carriage and Insurance Paid to

Shitësi i paguan shpenzimet e transportit, duke përfshirë sigurimin e transportit deri në vendin e destinuar. Ai bart rrezikun përsipër deri sa malli të pranohet nga transportuesi i parë.

IX. Adresa të rëndësishme

Adresat e internetit të Institucioneve të Kosovës

Kuvendi i Kosovës: <http://www.kuvendikosoves.org/>

Zyra e Kryeministrit të Kosovës: <http://www.ks-gov.net/pm>

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: <http://www.mti-ks.org/>

Ministria e Ekonomisë dhe Financave: <http://www.mfe-ks.org/>

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: <http://www.ks-gov.net/masht>

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: <http://mafrd-ks.org/>

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: <http://www.ks-gov.net/mpms>

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit: <http://www.mtpt.org/>

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: <http://www.mmph.org/>

Ministria e Shërbimeve Publike: <http://www.ks-gov.net/mshp>

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës: <http://www.bpk-kos.org/>

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare: <http://www.arbk.org/>

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit: <http://www.kta-kosovo.org/>

Doganat e UNMIK: <http://www.unmikcustoms.org/>

Enti i Statistikës të Kosovës: <http://www.sok-kosovo.org/>

Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës: <http://www.scaak-ks.org/>

Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës: <http://www.kpst.org/>

Korporata Energjetike e Kosovës: <http://www.kek-energy.com/>

Posta dhe Telekomu i Kosovës: <http://www.ptkonline.com/>

Adresat e internetit të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë

UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë: <http://www.unmikonline.org/>

Bashkimi Evropian në Kosovë: <http://www.euinkosovo.org/>

Banka Botërore - Kosovë: <http://www.worldbank.org/kosovo>

Agjencia Evropiane për Rindërtim: <http://www.ear.eu.int/kosovo>

UNDP Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara-Kosovë: <http://www.ks.undp.org/>

Misioni i OSBE-së në Kosovë: <http://www.osce.org/kosovo>

Bankat

Raiffeisen Bank

Rr. UÇK 51
10000 Prishtinë
Tel.: +381 (0) 38 226 400, 401
Fax.: +381 (0) 38 226 408
<http://www.raiffeisen-kosovo.com>
info@raiffeisen-kosovo.com

ProCredit Bank

Rr. Skenderbeu
10000 Prishtina
Tel.: +381 (0) 38 240 248
Fax.: + 381 (0) 38 248 777
<http://www.procreditbank-kos.com>
info@procreditbank-kos.com

New Bank of Kosova

Nena Tereze 49/A
10000 Prishtina
Tel.: +381 (0) 38 223 976
Fax.: + 381 (0) 38 226 112
<http://www.brk-bank.com>
brk-bank@brk-bank.com

KASABank

Rexhep Luci 5
10000 Prishtina
Tel.: +381 (0) 38 246 180
Fax.: +381 (0) 38 246 189
<http://www.kasabank.com>
kasabank@kasabank.com

Economic Bank

Migjeni 1
10000 Prishtina
tel. +381 (0) 38 244 396
fax. + 381 (0) 38 243 828
<http://www.bekonomike.com>
bek@bekonomike.com

Bank for Business

Rr. UÇK 41
10000 Prishtina
Kosovo / UNMIK
Tel.: +381 (0) 38 244 666
Fax.: + 381 (0) 38 243 656, 657
<http://www.bpb-bank.com>
hq@bpb-bank.com

Credit Bank of Prishtina

Tirana 29
10000 Prishtina
Tel.: +381 (0) 38 249 851
Fax.: + 381 (0) 38 248 468
<http://www.bkpbank.com>
management@bkpbank.com

Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare

Agro Business Development Unit

Rr. Bedri Shala 38 C
10000 Prishtina
+381 (0) 38 248 938
+381 (0) 38 245 940
adas4@agrobusiness.ipko.org

Vilesa CO

Rruga e Brigadave 123
23000 Therande
+381 (0) 29 71 695
+381 (0) 29 71 695

Atlantic Capital Partners LLC

UCK Street, 12
10000 Prishtina
+381 (0) 38 223 311
www.acapitalpartners.com
info@acapitalpartners.com

Beselidhja

Agim Ramadani Street 15
10000 Prishtina
+381 (0) 38 225 023
+381 (0) 38 245 017
www.bzmf.org
info@bzmf.org

Cordaid

Nena Tereze, p.n.
50000 Gjakove
+381 (0) 390 24 888
www.keponline.net
sdomi@keponline.net

IOM

Ismail Qemalli, 18
10000 Prishtina
+381 (0) 38 249 042 , 249 060
+381 (0) 38 249 039
www.iom.ipko.org
rjovanovic@iom.ipko.org, smoreau@iom.ipko.org

KGMAMF

Rruga 154, 122
30000 Peje
+381 (0) 39 32 842
www.grameen.com
kqmpeje@yahoo.com

Kosova Aid and Development

Skenderbeu, 266
11000 Podujeve
+381 (0) 38 571 744
+381(0) 38 571 745
lwc_kosova@hotmail.com, eset_qerimi@hotmail.com

Meshtekna

22000 Dragash
+377 (0) 44 201 043
meshtekna@yahoo.it

Start

Rasim Kiqina Street, 5
13000 Drenas
+381 (0) 38 585 051, 585-036
mfi_start@yahoo.com

DEG

Belvedere Strasse , 40
50933 Köln
Germany
+49 221 4986 11 54; +49 221 4986 1513
www.deginvest.de
shw@deginvest.de

Agency for Finance in Kosova

150/3 Street, 67/A
30000 Peje
+381 (0) 39 34 923
+381 (0) 39 33 322
mehribaneshala@yahoo.com
afk_info@yahoo.com

Balkanactie

Davidovc
72000 Shtime
+377 (0) 44 311 404
www.balkanactie.be
balkanactie_kosovo@web-sat.com,
agron.arifi@balkaninitiative.ipko.net

Ce.L.I.M

Rr. UÇK , 5
50000 Gjakove
+381 (0) 390 21 484
www.celim.org
petrit_hasanaj@hotmail.com

FINCA

20000 Prizren
+381 (0) 29 25 062; 44 962
+381 (0) 38 247 925
agnesavezgishi@yahoo.com

KEP-Kosovo Enterprise Program

Bedri Pejani Street 4
10000 Prishtina
+381 (0) 38 243 586
+381 (0) 38 243 590
www.keponline.net
lqashi@keponline.net

KosInvest World Vision

Zahir Pajaziti, 96
11000 Podujeve
+381 (0) 38 571 631
www.wvi.org
arta_spahija@wvi.org

Kreditimi Rural i Kosoves

Rr. UÇK, ndërtesa e Procredit Bankës, kati i tretë
10000 Prishtinë
+381 (0) 38 243 554
lulzimsadrija@hotmail.com

Perspektiva 4

Rr. Lidhja e Prizrenit
32000 Kline
+377 (44) 352 620
perspektiva4@yahoo.com

Kompanitë e licencuara të sigurimit

Kompania e sigurimit DARDANIA

Rr. Nëna Terezë
Prishtinë
Tel.: +381 38 244 080, +381 38 244 081

Kompania e sigurimit DUKAGJINI

Bulevardi i Dëshmorëve
Prishtinë
Tel.: + 381 38 543 575, + 381 38 576 577

Kompania e sigurimit KOSOVA E RE

Fazli Graiqevci 5
Prishtinë
Tel.: + 381 38 244 081; + 381 38 229 455

Kompania e sigurimit SIGURIA

Qamil Hoxha 15
Prishtinë
Tel.: + 381 38 248 850

INSIG Tiranë

Dega "INSIG" Prishtinë,
Pejton 4
Prishtinë,
Tel.: + 381 38 259 902

Kompania e sigurimit SIGAL Tiranë

Dega "Sigal - Drini", Prizren
Vellusha e Poshtme 16
Tel.: + 381 29 42 772, + 381 29 44 025

Kompania e sigurimit SIGMA Tiranë

Dega "SIGMA"
Pashko Vasa p.n
Prishtinë,
Tel.: + 381 38 246 301, + 381 38 246 302

Kompania e sigurimit CROATIA SIGURIMI

Fehmi Agani 69, D/1-2
Prishtinë,
Tel.: + 381 38 246 - 956, Fax.: + 381 38 246 957

Asistencë dhe informata për biznes

Nisma Ekonomike për Kosovën – Economic Initiative for Kosova (ECIKS)

Vjenë, Austri

Web: www.eciks.org

E-Mail: info@eciks.org

Oda Ekonomike e Kosovës

Ruga Nëna Terezë 20

Tel.: +381 (0) 38 524 741

Fax.: +381 (0) 38 23 397

Web: <http://www.odaekonomike.org/>

Instituti Riinvest

Bregu i Diellit p.n.

Prishtinë

Tel.: +381 (0) 38 549 320

Web: <http://www.riinvestintitute.org>

Kosovo Business Support – KBS

Rr. Nazim Hikmet Nr. 116

Arbëria, Prishtinë

Tel.: +381 38 243 631

Fax.: +381 38 517 216

Web: <http://www.usaidkbs.com>

Central and Eastern European Law Initiative (CEELI)

Rr. Ismail Qemali 47

Arbëria, Prishtinë

Tel.: +381 38 524 104

World Bank Office

Ruga Tirana 35

Prishtinë

Tel.: +381 (0) 38 549 459 ose 549 998

Fax.: +381 (0) 38 549 780

Web: <http://www.worldbank.org>

Aviokompanitë

Kosova Airlines

Vellusha e Poshtme 17

"Te Kino Rinia"

Tel.: +381 38 24 91 85, +381 38 24 91 84

Fax.: +381 38 24 91 86

Mobil: +377 44/11 37 86

Web: <http://www.kosovaairlines.com>

Albanian Air

Tel.: +377 44 145 190

Zyra e biletave në aeroportin e Prishtinës

Austrian Airlines

Tel.: +43 51789, Vjenë

Adria Airways

Tel.: +381 (0) 38 548 437



Zyra e biletave në aeroportin e Prishtinës

Swiss

Tel.: +381 (0) 38 548 438/439

Zyra e biletave në aeroportin e Prishtinës

X. Aneks: Aplikacioni për regjistrim fillestar të biznesit

 UNMIK	Qeveria e Kosovës Government of Kosovo Vlada Kosova ZYRA E REGJISTRIMIT TË NDËRMARRJEVE DHE EMRAVE TREGTARË NË KOSOVË KOSOVO REGISTRY OF BUSINESS ORGANIZATIONS AND TRADE NAME MATIČNI URED KOSOVA ZA UPIS PREDUZEĆA I POSLOVNIH IMENA A-0	 IPVQ
Vetëm për shfrytëzim zyrtar / For Official Use Only/ / Samo za službenu upotrebu		
Numri i fletëparaqitjes / Application Number / Broj zahteva Numri i biznesit / Business ID/ Broj biznisa		
Fletëparaqitja për regjistrim fillestar të Shoqërisë akcionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj Application for a initial registration a Joint Stock Company, Limited Liability Company, limited partnership or a foreign company Zahtev za početnu registraciju Deoničarskih Društava, Društava sa Ograničenom Odgovornošću, Ograničenog partnerstva ili Inostranog društva		
1. Emri i biznesit / Name of Business / Ime biznisa:		
2. Emri tregtar / Trade Name / Trgovačo ime:		
3. Adresa e biznesit /Business Adress / Adresa biznisa:		
Shteti/Territori – Country/Territory – Država/ Teritorija		Komuna / Municipality / Opština
Venbanimi / Place / Naselje		Rruga dhe nr / Street and no / Ulica i br.
Tel/Fax:		E-mail:
Faqja e internetit / Web site/ Internet Stranica:		
4. Tipi i biznesit /Type of Business/ Tip biznisa:		
3	Ortakëri e kufizuar / Limited partnership/ Ograničeno partnerstvo	
4.	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara/ Limited liability company/ Društvo sa ograničenom odgovornošću	
5.	Shoqëri akcionare / Joint stock company / Deoničarsko društvo	
6.	Kompani e huaj/ Foreign Company/ Inostrano društvo *Bashkangjite vërtetimin/ *Attach incorporation certificate *Priložiti potvrdu)	
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nëse është kompani e huaj (e formuar jashtë Kosovës) shëno juridiksionin nën të cilin hyn(vendin e inorporimit), ◆ If a foreign company (incorporated outside Kosovo) state jurisdiction of incorporation (Country) ◆ Ukoliko je inostrano društvo (osnovano izvan Kosova) navedite pravosudnog organa koji ga je registrovao (mesto registracije) 		
5. Data e konstituimit / Constituon date / Datum konstituisanja		
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Data e miratimit të statutit ose marrëveshjes së ortakërisë / Date of the charter or partnership agreement Datum donošenja statuta ili sporazuma partnerstva ◆ Bashkangjiite kopjen/ Attach a copy/ Priložite kopiju : 		

7. Kapitali themelor / Initial capital / Osnivački capital:**6. Numri i puntorëve / Number of employees / Broj radnika:**

Numri i Certifikatës doganore – Bashkangjite kopjen:

Customs number - attach a copy of the licence:

Broj carinske dozvole – Priloži kopju dozvole:

Numri i Certifikatës tatimore – Bashkangjite kopjen

Taxis number - Attach a copy of the licence:

Broj Poreske dozvole - Priloži kopju dozvole:

7. Kapitali themelor / Initial capital / Osnivački capital:◆ **Shuma e përgjithshme e kapitalit €**◆ **Total capital €**

◆ Ukupan iznos

kapitala €

◆ **Pjesa e paguar/ Paid part / Uplaçeni deo:**

◆ Numri i aksioneve, vlera dhe kategoria e aksioneve (vlen vetëm për korporatat);

◆ Number of shares, par value and class(es) of shares (for corporations only);

◆ Broj deonica, iznos i kategorije deonica (važi samo za korporacije)

Numri i aksioneve / Number of shares / Broj deonica

Vlera nominale / Nominal value / Nominalna vrednost

Klasa / Klass / Klasa

8. Veprimtaritë / Activities / Delatnosti

◆ Aktiviteti kryesor i biznesit

◆ Main activity of the business

◆ Glavna delatnost bisnisa

Kodi nr / Code no/ Šifra br. **Përshkrimi / Description/ Opis**

◇ Aktivitetet sekondare

◇ Secondary activity

◇ Sporedne delatnosti

Kodi nr / Code no/ Šifra br. **Përshkrimi / Description/ Opis**

◇ Aktivitetet tjera

◇ Other activity

◇ Ostale delatnosti

Kodi nr / Code no/ Šifra br. **Përshkrimi / Description/ Opis**

9. Pronarët e biznesit / Owners of the business / Vlasnici biznisa	Numri I pronarëve Number of the owners Broj vlasnika	
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Përgjegjësia e pakufizuar / Unlimited liability/ Neograničena odgovornost		
Përgjegjësia e kufizuar/ Limited liability/ Ograničena odgovornost :		
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Përgjegjësia e pakufizuar / Unlimited liability/ Neograničena odgovornost		
Përgjegjësia e kufizuar/ Limited liability/ Ograničena odgovornost :		
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Përgjegjësia e pakufizuar / Unlimited liability/ Neograničena odgovornost		
Përgjegjësia e kufizuar/ Limited liability/ Ograničena odgovornost :		
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Përgjegjësia e pakufizuar / Unlimited liability/ Neograničena odgovornost		
Përgjegjësia e kufizuar/ Limited liability/ Ograničena odgovornost :		
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Pjesa në pronësi/ Owned part/ Deo u vlasništvu:		
Përgjegjësia e pakufizuar / Unlimited liability/ Neograničena odgovornost		
Përgjegjësia e kufizuar/ Limited liability/ Ograničena odgovornost :		

Kopjoni këtë faqe nëse keni për të shtuar më shumë pronarë
Copy this page if you need to add more owners
Iskopirajte ovu stranu ukoliko je potrebno da navedete više vlasnika

10. Drejtori - Bordi i Drejtorëve Director - Board of Directors Direktor – Bord Direktora	Numri I Drejtorëve Number of the Directors Broj Direktora	
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Vendi i punës (pozita) në biznes / Position(s) in the business / Radno mesto(a) unutar bisnisa		
Autorizimet/Informata plotësuese Authorisations/ Additional information Ovlašćenja/ Dopunske informacije		
Tel/Fax:		E-mail:
Faqja e internetit / Web site/ Internet Stranica:		
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Vendi i punës (pozita) në biznes / Position(s) in the business / Radno mesto(a) unutar bisnisa		
Autorizimet/Informata plotësuese Authorisations/ Additional information Ovlašćenja/ Dopunske informacije		
Tel/Fax:		E-mail:
Faqja e internetit / Web site/ Internet Stranica:		
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Vendi i punës (pozita) në biznes / Position(s) in the business / Radno mesto(a) unutar bisnisa		
Autorizimet/Informata plotësuese Authorisations/ Additional information Ovlašćenja/ Dopunske informacije		
Tel/Fax:		E-mail:
Faqja e internetit / Web site/ Internet Stranica:		
Emri/ Name / Ime		
ID (ID-a personale/ ID-a e SL) ID (Personal ID/LE ID)ID (Lični ID/ ID PL)		
Shteti /Territori/ Country/Territory/ Država/Teritorija		
Komuna/ Municipality/ Opština		
Vendi/ Place/ Naselje		Rruga/ Street/ Ulica
Vendi i punës (pozita) në biznes / Position(s) in the business / Radno mesto(a) unutar bisnisa		
Autorizimet/Informata plotësuese Authorisations/ Additional information Ovlašćenja/ Dopunske informacije		
Tel/Fax:		E-mail:
Faqja e internetit / Web site/ Internet Stranica:		

Kopjoni këtë faqe nëse keni për të shtuar më shumë Drejtorë
Copy this page if you need to add more Directors

Iskopirajte ovu stranu ukoliko je potrebno da navedete više Direktora

11. Njësitë – Branches – Jedinice		Numri – Number - Broj	
Emri i njësisë Name of branch Ime poslovnice			
Shteti/Territori/ Shteti/TerritoriDržava/Teritorija			
Komuna/ Municipality/ Opština			
Vendi PlaceNaselje		Rruga/ Street/ Ulica	
Tipi i njësisë / Type of branch / Tip jedinice			
Përshkrimi/ Description/ Opis			
Aktiviteti kryesor i biznesit Main activity of the business Glavna delatnost biznisa		Kodi/Code/Šifra	
Emri i njësisë Name of branch Ime poslovnice			
Shteti/Territori/ Shteti/TerritoriDržava/Teritorija			
Komuna/ Municipality/ Opština			
Vendi PlaceNaselje		Rruga/ Street/ Ulica	
Tipi i njësisë / Type of branch / Tip jedinice			
Përshkrimi/ Description/ Opis			
Aktiviteti kryesor i biznesit Main activity of the business Glavna delatnost biznisa		Kodi/Code/Šifra	
Emri i njësisë Name of branch Ime poslovnice			
Shteti/Territori/ Shteti/TerritoriDržava/Teritorija			
Komuna/ Municipality/ Opština			
Vendi PlaceNaselje		Rruga/ Street/ Ulica	
Tipi i njësisë / Type of branch / Tip jedinice			
Përshkrimi/ Description/ Opis			
Aktiviteti kryesor i biznesit Main activity of the business Glavna delatnost biznisa		Kodi/Code/Šifra	
Emri i njësisë Name of branch Ime poslovnice			
Shteti/Territori/ Shteti/TerritoriDržava/Teritorija			
Komuna/ Municipality/ Opština			
Vendi PlaceNaselje		Rruga/ Street/ Ulica	
Tipi i njësisë / Type of branch / Tip jedinice			
Përshkrimi/ Description/ Opis			
Aktiviteti kryesor i biznesit Main activity of the business Glavna delatnost biznisa		Kodi/Code/Šifra	
Emri i njësisë Name of branch Ime poslovnice			
Shteti/Territori/ Shteti/TerritoriDržava/Teritorija			
Komuna/ Municipality/ Opština			
Vendi PlaceNaselje		Rruga/ Street/ Ulica	
Tipi i njësisë / Type of branch / Tip jedinice			
Përshkrimi/ Description/ Opis			
Aktiviteti kryesor i biznesit Main activity of the business Glavna delatnost biznisa		Kodi/Code/Šifra	

Kopjoni këtë faqe nëse keni për të shtuar më shumë Njësi

Copy this page if you need to add more Units

Iskopirajte ovu stranu ukoliko je potrebno da navedete više Jedinica

12. Informata plotësuese / Additional Informations / Važne napomene:

